

L I G J
Nr.7904, datë 8.3.1995

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7643, DATË 2.12.1992 “PËR INSPEKTORATIN
SANITAR SHTETËROR”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7643, datë 2.12.1992 “Për inspektoratin sanitar shtetëror” bëhen ndryshime si më poshtë:

- Në nenin 3, në fund shtohen fjalët “ose të ngarkuar me këto funksione”.
- Në fund të nenit 8 shtohet paragrafi: “Autorizohet Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit të nxjerrë rregullore higjieno-sanitare, të detyrueshme për zbatim nga ministrinë dhe organet e tyre vartëse, si dhe nga personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj”.
- Në nenin 26, pika 2, në fund të paragrafit shtohen fjalët: “Kur këto ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut”.
- Në nenin 26, pika 10 ndryshohet si më poshtë:
“Ndotja e burimeve dhe objekteve të tjera të ujit të pijshëm dhe derdhja e ujërave të institucioneve të ndryshme pa u dezinfektuar ose dezaktivizuar”.
- Në nenin 27, në paragrafin e parë, fjalët “neni 27” zëvendësohen me fjalët “neni 26”. Në paragrafin me përmbajtje “Shkeljet e parashikuara në pikat 10, 11, 12, 13, 15” shtohet edhe pika 9. Në paragrafin e parafundit hiqet fjala “ambulante” dhe në këtë paragraf shtohen fjalët “pa të drejtë ankimi”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1043, datë 20.3.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha